



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 761, Datë 22.01.2021

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “ Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A,

**VËREN SE:**

**Transaksioni dhe përqendrimi**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

Sipas Marrëveshjes Kuadër nënshkruar më datë 23 Dhjetor 2020 palët janë:

**Pala Blerëse:** Unione di Banche Italiane S.p.A është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionin Italian. Aktiviteti i saj fokusohet veçanërisht te menaxhimi i portofolit të klientëve individë.

Unione di Banche Italiane S.p.A zotërohet 100% nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

**Target:** Lombarda Vita S.p.A është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionin Italian, e cila operon si një shoqëri sigurimi, ekskluzivisht në shtetin italian.

**Pala Shitëse:** Societa Cattolica di Assicurazione – Societa Cooperativa është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian dhe operon si një shoqëri sigurimi.

### **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sigurimeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A. Unione di Banche Italiane S.p.A pas transaksionit do të marrë kontrollin e plotë të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A e cila është aktive në tregun e sigurimeve të jetës ekskluzivisht në Itali.

Unione di Banche Italiane S.p.A është pjesë e Grupit Financiar Intesa Sanpaolo, i cili realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Lombarda Vita S.p.A nuk është prezent në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar realizohet mes palëve që operojnë në tregje të ndryshme duke mos krijuar mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Lombarda Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**